

Tiranë, 4 Shtator 2026

LETËR E HAPUR

OBJEKTI: Për përmbushjen e detyrimeve parlamentare dhe rikthimin e mbrojtjes së zonave të mbrojtura

Zoti/Zonja Deputet/e

Në fillim të *sezonit të ri politik*, për të përmirësuar përfaqësimin tuaj në Parlamentin e Shqipërisë, duhet të jeni të vetëdijshëm që parlamenti po dështon të përmbushi një nga detyrimet thelbësore që i buron si fillim nga përgjegjësia për të përfaqësuar qytetarët e vendit.

Krahas kundërshtisë së shprehur në vitin 2024 kur u votuan ndryshimet në ligjin Për Zonat e Mbrojtura, qytetarët tashmë po kërkojnë prej muajsh në Bulevardin Dëshmorët e Kombit shfuqizimin e ligjit 21/2024 “Për Zonat e Mbrojtura” dhe rikthimin e tij në versionin 81/2017 si një nga kërkesat e protestës kombëtare.

Detyrimi për shfuqizimin e amendimeve të vitit 2024 në ligjin Për Zonat e Mbrojtura buron edhe nga Pozicioni i Përbashkët Negociues mes Shqipërisë dhe Komisionit Evropian në kuadër të negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Në këtë dokument, palët kanë rënë dakord për shfuqizimin e plotë të ndryshimeve të votuara në vitin 2024 në ligjin për zonat e mbrojtura.

Pavarësisht këtij detyrimi, parlamenti nuk ka bërë ende ndryshimet e nevojshme ndërkohë që autoritetet kanë vazhduar të planifikojnë projekte zhvillimore brenda zonave të mbrojtura.

Përgjatë muajit maj, vendi ynë u përball me një situatë të turpshme ku makineri të rënda mësynë brenda njërës prej zonave të mbrojtura më të rëndësishme, Pishë Poro-Nartë, dhe punuan pa një leje ndërtimi për një periudhë prej 26 ditësh duke shkaktuar dëme të konsiderueshme në habitatet e mbrojtura.

Pas kësaj ngjarjeje, edhe Parlamenti Evropian reagoi duke votuar masivisht amendimin 17 i cili krahas shfuqizimit të amendimeve të vitit 2024 në ligjin për zonat e mbrojtura, kërkoj

vendosjen e një moratoriumi urgjent për ndërtimet dhe lejet e reja brenda zonave të mbrojtura.

Me keqardhje, qindra mijëra njerez sot dëshmojnë që Parlamenti i Shqipërisë ka dështuar ta përmbushi edhe këtë kërkesë krahas shfuqizimit të plotë të amendimeve problematike.

Ju rikujtojmë se ligji “Për Zonat e Mbrojtura 81/2017” është një ligj i përafruar me standartet Evropiane dhe përmbush në pjesën më të madhe kriteret e Direktivës së Shpendëve dhe Habitaveve. Kështu që, ju bëjmë thirrje si deputet i Parlamentit të Shqipërisë të inicioni në mënyrë urgjente diskutimin dhe iniciativën për rikthimin e ligjit 81/2017 duke kthyer kështu edhe parlamentin në shërbim të qytetarëve bashke me frymën evropiane që duhet ta karakterizojë atë institucion në këtë moment ku Shqipëria ndodhet.

Shpresojmë në reagimin dhe angazhimin tuaj konkret për adresimin e kësaj çështjeje në Parlamentin e Shqipërisë.

Me respekt,

PPNEA